

‘ZHVILLIMI I KOMUNITETIT DHE QEVERISJA LOKALE – STUDIM
KRAHASUES I KOMUNAVE TË RAJONIT TË PRISHTINËS’

TEMA PËR TITULLIN
DOKTOR I SOCIOLOGJISË

NGA

FERDI KAMBERI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË

PRISHTINË

SHKURT, 2022

REZYME E PUNITIT TË DOKTORATËS

‘ZHVILLIMI I KOMUNITETIT DHE QEVERISJA LOKALE – STUDIM KRAHASUES I KOMUNAVE TË RAJONIT TË PRISHTINËS’

Mentor: Prof. Dr. Bekim Baliqi

Bashkëmentor: Prof. Dr. Agim Hyseni

Në vitet e fundit zhvillimi i komunitetit është konsideruar si një ndër çështjet më të rëndësishme të sociologjisë. Si filozofi sociale hynë në domenin e komunitarizmit dhe fokus ka raportin ndërmjet individit dhe komunitetit, ndërveprimet ndërmjet tyre, qëllimin, ndjenjën e të qenurit pjesë e komunitetit, rrjetëzimin social, besimin, vlerat, normat dhe kohezionin social ndërmjet anëtarëve të cilët janë një kapital social dhe identifikohen si pjesë e një komuniteti. Qeverisja lokale në anën tjetër është një segment i rëndësishëm i cili ka legjitimitet për organizimin e çështjeve publike lokale. Në Kosovë pjesëmarrja e komunitetit në qeverisje lokale zhvillohet përmes mekanizmave lokal të vendimmarrjes të cilat burojnë nga ligji për vetëqeverisje lokale. Një rol me rëndësi në kuadër të kësaj pjesëmarrjeje ka edhe shoqëria civile e cila është shtyllë fundamentale e demokracisë. Punimi me titull “*Zhvillimi i komunitetit dhe qeverisja lokale – studim krahasues i komunave të rajonit të Prishtinës*”, ka synim hulumtimin, analizën dhe krahasimin e zhvillimit të komunitetit, bashkëpunimin, komunikimin në mes tyre dhe akterëve lokal dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje dhe politikëbërje në komunat e rajonit të Prishtinës: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Drenas dhe Graçanicë. Metodologjia e përdorur në këtë punim, është fokusuar hulumtimin kuantitativ i realizuar në këto komuna me një mostër reprezentative prej 550 respondentë, hulumtimin kualitativ me intervista të thella gjysmë të strukturuar me ekspertë të komuniteteve dhe qeverisjes lokale, si dhe studime e analiza tjera shkencore. Rezultatet e përgjithshme të studimit tregojnë se komuniteti në këto komuna, akoma është në fazën fillestare të organizimit dhe bashkëpunimit si komunitet dhe pjesëmarrja në kuadër të vendimmarrjes publike konsiderohet se është e ulët. Kjo si rezultat i mos marrjes parasysh të propozimeve të komunitetit, mungesës së informimit adekuat, mungesës së kohës nga komuniteti dhe profilit të pjesëmarrësve në takimet publike, që shpeshherë dominohen nga anëtarë të partive politike në pushtet se sa komuniteti në fjalë. Prandaj, mos zhvillimi i komunitetit dhe pjesëmarrja e ulët në procesin e vendimmarrjes lokale është sinjal i një shoqërie pasive, ndikon në hermetizimin social të komunitetit dhe reflekton edhe në luhatjen e besimit ndaj institucioneve lokale.

Fjalët kyçe: *Zhvillimi i komunitetit, qeverisja lokale, komunat e rajonit të Prishtinës, vendimmarrja, politikëbërja.*

STRUKTURA E DISERTACIONIT

Struktura e disertacionit me titull ‘*Zhvillimi i komunitetit dhe qeverisja lokale – studim krahasues i komunave të rajonit të Prishtinës*’ përveç pjesës hyrëse, përmban edhe gjashtë kapituj, ka përfundimet, rekomandimet, literaturën e shfrytëzuar, si dhe anekset e veçanta, në të cilat janë paraqitur pyetëtori i realizuar me qytetarët dhe intervistat e thella gjysmë të strukturuar.

Hyrja e studimit – Në këtë segment është paraqitur fusha e studimit dhe çështjet kryesore të studimit të cilat janë trajtuar gjatë punimit në fjalë. Hyrja ka përfshirë qëllimin e studimit dhe disa nën qëllime të tjera, objektivat e studimit, pyetjen hulumtuese – kryesore, hipotezat e ngritura, rolin dhe rëndësinë e studimit, materialet e përdorura, metodologjinë preliminare të studimit, parashtrimin e problemit dhe strukturën e punimit.

Kapitulli i parë - Ky kapitull fokusohet në kornizën teorike të zhvillimit të komunitetit dhe qeverisjes lokale. Kapitulli është i orientuar më shumë në teorinë kryesore të cilat flasin për temën e lartcekur, si për teorinë: e komunitarizmit, teorinë e organizimit social të komunitetit, si dhe teorinë e shkallëve të pjesëmarrjes. Kapitulli, po ashtu flet për qasjen kritike ndaj këtyre teorive, karakteristikat e komunitetit, tipologjinë, si dhe konceptet kryesore.

Kapitulli i dytë – Ky kapitull fokusohet më shumë rreth demokracisë dhe raportit me qeverisjen lokale, pastaj parimet dhe modelet e demokracisë, raportin në mes të qeverisjes lokale dhe shoqëritë post-konfliktuale, kronologjinë historike të sistemit të vetëqeverisjes lokale në Kosovës, baza ligjore mbi qeverisjen lokale në Kosovë, duke përfshirë këtu edhe ndryshimet e legjislacionit, zhvillimin e vetëqeverisjes lokale pas vitit 1999, strukturat institucionale në nivel lokal, raportin në mes të nivelit lokal dhe atij qendror, raportin në mes të nivelit lokal dhe komunitetit, mekanizmat lokal të pjesëmarrjes në vendimmarrje të komunitetit në nivel lokal, roli i profilit gjinor në raport me komunitetin, si dhe rolin e shoqërisë civile në zhvillimin e komunitetit dhe të qeverisjes lokale.

Kapitulli i tretë - Kapitulli flet për rastin studimor të krahasimit në mes të komunave të rajonit të Prishtinës, komunave: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Drenas dhe Graçanicë sidomos në aspektin e qeverisjes lokale dhe komunikimit me komunitetin. Kapitulli fokus ka profilin e komunave të rajonit të Prishtinës, krahasimin e komunave të këtij rajoni në procesin e zgjedhjeve lokale, krahasimin e komunave të rajonit të Prishtinës për sa i përket zhvillimit të komunitetit, pastaj krahasimin e këtyre komunave lidhur me pjesëmarrjen e komunitetit në

vendimmarrje, krahasimin e komunave në procesin e vendimmarrjes përmes Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, zhvillimin e takimeve publike dhe rolin e komunitetit, mekanizmat lokal të vendimmarrjes dhe shfrytëzimin e tyre nga ana e komunitetit për shfrytëzuar të drejtat e tyre demokratike, si dhe në disa aspekte të tjera të rëndësishme të cilat ndikojnë që komuniteti të ketë një zhvillim e sipërm.

Kapitulli i katërt – Flet më shumë për komunikimin në mes të pushtetit lokal dhe komunitetit, formave të komunikimit në mes të palëve, mënyrën e informimit të komunitetit për çështjet e takimeve publike dhe çështjet tjera me rëndësi, rolit të medieve sa dhe si kushtojnë rëndësi zhvillimit të komunitetit dhe qeverisjes lokale në komunat e rajonit të Prishtinës, ofrimin e shërbimeve publike nga ana e pushtetit lokal në këto komuna dhe raportin me komunitetin, si dhe sigurinë publike dhe raportin në mes të komunitetit dhe qeverisjes lokale në komunat në fjalë.

Kapitulli i pestë – Prek më shumë rreth çështjes së dhënave dhe metodologjisë së punës kërkimore të hulumtimit të zhvilluar në terren. Kapitulli trajton në mënyrë të detajuar variablat e përdorura dhe të testuara, metodat e hulumtimit, teknikat dhe instrumentet e dy hulumtimeve kryesore: hulumtimi kuantitativ dhe ai kualitativ. Kapitulli fokusohet edhe në të dhënat biografike të të anketuarve me rastin e zhvillimit të hulumtimit kuantitativ dhe të dhënat tjera me rastin e zhvillimit të hulumtimit kualitativ. Rëndësi të veçantë kanë metodat tjera të zhvilluar, si: metoda e vëzhgimit, metoda e studimit të literaturës, metoda historike, metoda e komparacionit, deskriptive, metodën juridike pastaj analiza e të dhënave dhe kryqëzimi i tyre i përpunuar me programin SPSS Nr. 24, analiza statistikore, analiza e përmbajtjes mediale dhe analiza e ueb faqeve zyrtare të komunave në fjalë.

Kapitulli i gjashtë – Ky kapitull fokus të veçantë ka rezultatet e hulumtimit dhe diskutimit. Kapitulli fokusohet më shumë rreth gjetjeve kryesore gjatë dy hulumtimeve: hulumtimit kuantitativ dhe kualitativ të cilat kanë qenë hulumtime kryesore në këtë punim.

Pjesa e përfundimit, rekomandimet, literatura dhe pjesa e anekseve – Kjo pjesë flet për përfundimet e përgjithshme të punimit të cilat kanë dalë si rezultat i shtjellimit të punimit, rekomandimet dhe literatura/burimet të cilat kanë shërbyer për finalizimin e këtij punimi. Në fund janë vendosur anekset (appendix) të cilat përmbajnë pyetëtorin dhe intervistën si modele të cilat i kemi realizuar gjatë hulumtimit në terren.

SUMMARY OF DOCTORATE THESIS

‘COMMUNITY DEVELOPMENT AND LOCAL GOVERNMENT - A COMPARATIVE STUDY OF MUNICIPALITIES OF REGION OF PRISHTINA’

Supervisor/Mentor: Prof. Dr. Bekim Baliqi

Co-Supervisor/Co-Mentor: Prof. Dr. Agim Hyseni

In recent years, community development has been considered as one of the most issues of sociology. As a social philosophy, it falls into the domain of communitarianism and its focus is the relationship between the individual and community, the interaction between them, the purpose, the sense of being member of the community, social networking, beliefs, values, norms and the cohesion between the members who are the social capital and are identified as members of the community. The local government on the other hand is an important segment which has the legitimacy to organize the local public affairs. In Kosovo the participation of the community in local government is conveyed through the mechanisms of local decision-making which derives from the law on local self-government. A very important role in this participation plays the civil society, as a fundamental pillar of democracy. This paperwork “Community development and local self-governance – comparative study of the municipalities of Pristina region” aims to research, analyse and compare community development, cooperation, communication between them and other local community members, and their participation in decision and policy making in the municipalities of Pristina region: Pristina, Fushe Kosove, Obilic, Drenas and Gracanica. The methodology used in this paperwork, is focused in quantitative research conducted in these municipalities, a representative sample of 550 respondents, qualitative research with in-depth semi-structured interviews with different community and local government experts as well as other scientific studies and analyses. The overall results of the study show that the community in these municipalities is still at initial stage of organization and cooperation as community and participation in the public decision making is being considered to be very low. And this due to disregard of proposals coming from the community, lack of adequate information, lack of time from community side and profile of participants in public meetings often dominated by members of governing parties rather than the community in question. Therefore, the lack of community development and low participation in local decision-making process is the sign of a passive society, influences the community’s social hermetization and also reflects on the fluctuation of confidence in local institutions.

Keywords: *Community development, local government, municipalities of Pristina region, decision-making, policy-making.*

DISSERTATION STRUCTURE

The structure of the dissertation entitled '*Community Development and Local Government - A Comparative Study of Municipalities of Region of Prishtina*' in addition to the introductory part, the paper contains six chapters, conclusion, recommendations, literature review, and separate annexes, contains the questionnaire conducted with citizens and in-depth semi-structured interviews.

Introduction - In this part is presented the field of study and the main issues of the study which were addressed during the paper. The introduction include the purpose of the study and some other sub-purposes, study objectives, research main question, hypotheses raised, role and importance of the study, materials used, preliminary study methodology, presented problems and structure of the paper.

Chapter One - This chapter focuses on the theoretical framework of community development and local governance. The chapter is more oriented to the main theories which talk about the above topic, such as the theory of: communitarianism, the theory of social organization of the community, as well as the theory of degrees of participation. The chapter also discusses the critical approach to these theories, community characteristics, typology, and key concepts.

Chapter Two - This chapter focuses more on democracy and the relationship with local government, then the principles and models of democracy, the relationship between local government and post-conflict societies, the historical chronology of the local self-government system in Kosovo, the legal basis on governance in Kosovo, including changes in legislation, development of local self-government after 1999, institutional structures at the local level, the relationship between the local and central level, the relationship between the local level and the community, local mechanisms for participation in community decision-making at the local level, the role of gender in relation to the community, as well as the role of civil society in community development and local government.

Chapter three - The chapter talks about the case study comparison between municipalities in the region of Prishtina, municipalities: Prishtina, Fushë Kosovë, Obiliq, Drenas and Graçanicë especially in terms of local government and communication with the community. The chapter has focus the profile of the municipalities of the Prishtina region, the comparison of the

municipalities of this region within the local election process, the comparison of the municipalities of the Prishtina region in terms of community development, then the comparison of these municipalities regarding community participation in decision making, comparing municipalities in the decision-making process through village councils, settlements and urban neighbourhoods, organizing public meetings and the role of the community, local decision-making mechanisms and their use by the community to exercise their democratic rights, as well as in some other important aspects which influence to the community to have a superior development.

Chapter Four - Talks more about communication between local government and the community, models of communication between the parties, how to inform the community about public meetings and other important issues, the role of the media and how they pay attention to development of community and local government in the municipalities of the Prishtina region, the provision of public services by the local government in these municipalities and the relationship with the community, as well as public safety and the relationship between the community and local government in the municipalities in question.

Chapter Five - Touches more on the issue of data and the methodology of research and research conducted in the field. The chapter deals in details with the used and tested variables, research methods, techniques and instruments of the two main researches: quantitative research and qualitative research. The chapter also focuses on the biographical data of the respondents when conducting quantitative research and other data when conducting qualitative research. Of special importance are other developed methods, such as: observation method, literature study method, historical method, comparison method, descriptive, legal method, then data analysis and their cross-processing elaborated with SPSS program no. 24, statistical analysis, analysis of media content and analysis of official websites of the municipalities of the region of Prishtina.

Chapter Six - This chapter focuses more on the results of research and discussion. The chapter focuses more on the main findings during the two method of research: quantitative and qualitative research which have been the main researches in this paper.

Conclusion section, recommendations, literature and annexes - This section talks more about the general conclusions of the paper which have emerged as a result of the elaboration of the paper, recommendations and literature / resources which have served to finalize this paper. At

the end of the paper are annexes (appendix) which contain the questionnaire and the interview as models which we realized during the field research.